

Garë ndërkombëtare KENGUR 17.03.2016


Klasa e 4 dhe 5 - Kategorija Ecolier

Koha në disponim është 1h e 15 min.

Për përgjigje jo të saktë të pyetjes minusohet një e katërta e numrit të pikëve me të cilat vlerësohet kjo pyetje. Për të shmangur rezultat të përgjithshëm negativ në fund shtohen 24 pikë, kështu që sasia maksimale e pikëve të fituara është 120. Gjatë punës nuk lejohen kalkulatorët.

Çdo detyrë me numër rendor nga 1 deri 8 vlerësohet me 3 pikë


1. Ema, Bojan, Kire, Dena dhe Elena hodhën nga dy zare dhe e mbledhën numrin e pikëve të rëna. Cili fitoi shumën më të madhe?



- (A) Ema (B) Bojan (C) Kire (D) Dena (E) Elena

2. Kenguri i vogël Kanga ka 7 javë dhe 2 ditë. Pas sa ditësh Kanga do të ketë 8 javë?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5




3. Në vizatimin djathtas është dhënë skemë për llogaritje. Cili numër duhet të jetë në vendin e pikëpyetjes?

- (A) 24 (B) 28 (C) 36 (D) 56 (E) 80



4. Palaçoja Pipo përgatitej për shfaqjen e cirkut të mbrëmjes (vizatimi djathtas). Para se të fillonte të luante ai u pa në pasqyrë. Çfarë pa Pipo në pasqyrë?



5. Miri dhe Lola shkuan në cirk. Karriget e tyre kishin numrat 71 dhe 72. Në hyrje të cirkut ka tabelë në të cilën janë paraqitur drejtimet me qëllim që të arrihet tek karriget (vizatimi djathtas). Në cilin drejtim duhet të shkojnë Miri dhe Lola?

- (A) (B) (C) (D) (E)


	radha 1 deri 20
	radha 21 deri 40
	radha 41 deri 60
	radha 61 deri 80
	radha 81 deri 100

6. Lola dhe pesë shoqet e saj ndanë disa mollë. Secila prej tyre mori nga gjysmë molle. Sa mollë ndanë Lola me shoqet?

(A) 2 e gjysëm (B) 3 (C) 4 (D) 5 (E) 6


7. Një pjesë e drejtkëndëshit është e fshehur pas perdes. Cila është forma e pjesës së fshehur?

(A) trekëndësh (B) katror (C) gjashtëkëndësh
(D) rreth (E) drejtkëndësh



8. Cila nga fjalitë e mëposhtme e përshkruan saktë gjendjen e figurës djathtas?

(A) Ka aq rrathë sa ka edhe katrorë.
(B) Ka më pak rrathë se sa trekëndësha.
(C) Ka dy herë më shumë rrathë se sa trekëndësha.
(D) Ka më shumë katrorë se sa trekëndësha.
(E) Ka dy trekëndësha më shumë sesa rrathë.




Cdo detyrë me numër rendor nga 9 deri 16 vlerësohet me 4 pikë

9. Shuma e shifrave të vitit 2016 është e barabartë me 9. Cili është viti pasardhës në të cilin shuma e shifrave do të jetë përsëri e barabartë me 9?

(A) 2007 (B) 2025 (C) 2034 (D) 2108 (E) 2134

10. Miu do që të dalë nga labirinti (figura djathtas). Sa rrugë të ndryshme egzistojnë të tilla që miu të mos kalojë në të njëjtën derë më shumë se sa njëherë?

(A) 2 (B) 4 (C) 5
(D) 6 (E) 7









11. Lola ka dy letra. Ajo shkroi nga një numër në të dyja anët e letrave. Shuma e numrave të shkruar në njërin letër është e njëjtë me shumën e numrave të shkruar në letrën tjetër. Shuma e katër numrave është 32. Cilët mund të jenë numrat në anët e letrave që nuk i shikojmë?



(A) 7 и 0 (B) 8 и 1 (C) 11 и 4 (D) 9 и 2 (E) 6 и 3

12. Cilën prej figurave të vogla të dhëna duhet t'a vendosim në mes të figurës së madhe në mënyrë që vijat me ngjyrë të njëjtë të preken ?



13. Në orën e matematikës pesë nxënësve iu dha nga një katror, trekëndësh dhe rreth, të prera prej fletë letreje. Më pas, secili prej tyre tre figurat e mara i vendosi njëra mbi tjetrën, siç është treguar në vizatimin më lart. Sa nxënës e vendosën trekëndëshin mbi katror ?




(A) 0

(B) 1

(C) 2

(D) 3

(E) 4



14. Në vizatimin djathtas janë dhënë pesë figura. Me cilat tre figura mund të formohet katror ?


(A) 1, 3 dhe 5

(B) 1, 2 dhe 5

(C) 1, 4 dhe 5

(D) 3, 4 dhe 5

(E) 2, 3 dhe 5



15. Miri duhet t'a plotësojë tabelën e dhënë në vizatimin djathtas, por kështu që në çdo rresht dhe çdo kolonë saktësisht nga një herë të përmbahen numrat 1, 2 dhe 3. Sa është shuma e të dy numrave të cilët Miri duhet t'i shkruaj në katrorët e shënuar me shkronjat A dhe C?

(A) 2

(B) 3

(C) 4

(D) 5

(E) 6

1		
	2	A
		B

16. Miri ka 8 monedha dhe shirit të përbërë prej 11 katrorëve të vegjël. Ai i vendos të gjitha monedhat në katrorë. Pastaj, në një katror vendos nga një monedhë dhe midis dy katrorëve me monedha nuk ka katror bosh. Cili është numri më i madh i katrorëve për të cilët jemi të sigurtë që në to janë vendosur monedha?


(A) 1

(B) 3

(C) 4






(D) 5

(E) 6



Cdo detyrë me numër rendor nga 17 deri 24 vlerësohet me 5 pikë

17. Kur figura do të kthehet nga e djathta, mund të shihet çfarë është vizatuar në të (shiko vizatimin). Çfarë do të shihet nëse figura rrotullohet sipër?



18. Marko, Mirko dhe Mitko janë trinjakë (tre vëllezër të lindur në të njëjtën ditë). Vëllai i tyre Petar është saktësisht tre vjet më i madh. Cili prej numrave të mëposhtëm mund të jetë shuma e viteve të të katër vëllezërve?

(A) 25

(B) 27

(C) 29

(D) 30

(E) 60

19. Në një kopsht magjik rriten pemë magjike. Në çdo pemë magjike ka ose nga 6 dardha dhe 3 mollë ose nga 8 dardha dhe 4 mollë. Tek pemët ka 25 mollë. Sa dardha ka nëpër pemë?


(A) 35 (B) 40 (C) 45
(D) 50 (E) 56



20. Qenushët e mi kanë 18 këmbë më shumë sesa hundë. Sa qenushë kam?

(A) 4 (B) 5 (C) 6 (D) 8 (E) 9

21. Miri do të rendisë pesë enë sipas peshës së tyre. Ai tashmë i renditi enët Q, R, S dhe T, ku ena T ishte më e rëndë (vizatimi djathtas).



Ku duhet të vendoset ena Z?

(A) majtas enës Q (B) midis enës Q dhe enës R (C) midis enës R dhe enës S
(D) midis enës S dhe enës T (E) djathtas enës T

22. Ana mbledhi shtatë numra dhe fitoi 2016. Njëri prej mbledhësve është numri 201. Ajo e zëvendësoi numrin 201 me numrin 102, dhe pastaj përsëri i mbledhi numrat. Cilin numër e fitoi Ana?

(A) 1815 (B) 1914 (C) 1917 (D) 2115 (E) 2118


23. Miri ndërtoi një tra prej 27 kubesh (shiko vizatimin). Ai e ndau trarin në dy pjesë kështu që njëra pjesë është dy herë më e madhe se tjetra.



Më pas, Miri zgjodhi njëren prej dy pjesëve dhe e ndau në të njëjtën mënyrë. Duke vazhduar në të njëjtën mënyrë, cilën prej trarëve të mëposhtme nuk mund ta fitojë Miri?

(A) 2
(B) 4
(C) 6
(D) 8
(E) 10

24. Pesë zogj rrinë në degë siç është treguar në figurë. Çdo zog fishkëlleu aq herë sa është numri i zogjve që i shikon. Për shembull, Angel fishkëlleu katër herë. Pastaj, njëri prej zogjve u kthye në anën e kundërt. Përsëri çdo zog fishkëlleu aq herë sa është numri i zogjve që i shikon. Këtë herë, numri i fishkëllimave ishte më i madh se herën e parë. Cili zog u kthye?



(A) Angel (B) Berta (C) Carli (D) David (E) Ego